



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

AUTORITETI I KONKURRENCËS

Nr. 1285 prot.

Nr. 286 prot.

Tiranë, më 04.05.2018

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Preambul

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare i Republikës së Shqipërisë (AKEP) dhe Autoriteti i Konkurrencës (AK), që më poshtë ju referohemi me termin “Palët”,

Në zbatim të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (këtu e në vazhdim ligji nr.9121/2003) dhe legjislacionit në fushën e rregullimit dhe mbikëqyrjes së tregjeve elektronike dhe postare, kryesisht ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (këtu e në vazhdim ligji nr. 9918/2008); dhe (2) Ligji nr. 46/2015 “Për Shërbimet Postare në Republikën e Shqipërisë” (këtu e vazhdim ligji nr. 46/2015)

Duke njohur rëndësinë e komunikimeve elektronike në zhvillimin e mirëqenies shoqërore dhe ekonomike në terma afatgjatë në funksion të konsumatorit;

Me qëllim rritjen e bashkëpunimit në fushën e konkurrencës në tregjet e komunikimeve elektronike dhe postare në Republikën e Shqipërisë,

Duke konsideruar se:

- ✓ Ligji “Për mbrojtjen e konkurrencës” zbatohet në të gjitha sektorët, përfshirë komunikimet elektronike dhe postare;
- ✓ Rregullimi në fushën e komunikimeve elektronike duhet të respektojë parimin e paanshmërisë teknologjike;
- ✓ Është detyrim ligjor që AKEP-i të nxisë konkurrencën efiçente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, facilitetet shoqërore dhe shërbimet e tjera.
- ✓ Është detyrim i AK, që për zbatimin e Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” në sektorët e rregulluar të bashkëpunojë me entet dhe institucionet e tjera rregullatorë.



shprehin gatishmërinë të rrisin dhe forcojnë bashkëpunimin për çështje me interes të përbashkët që lidhen me zbatimin e legjislacionit në fuqi për konkurrencën e sektorit të komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar.

Palët e këtij Memorandumi Mirëkuptimi bien dakord të bashkëpunojnë me qëllim të shkëmbimit të përvojës dhe informacionit si me poshtë vijon:

Neni 1 Shkëmbimi i informacionit

- 1.1. AKEP-i dhe Autoriteti i Konkurrencës shkëmbejnë informacionin e nevojshëm, të cilin pala marrëse është e detyruar ta administrojë me të njëjtin nivel konfidencialiteti, si dhe pala dërguese.
- 1.2. Shkëmbimi i informacioneve bëhet sipas përcaktimeve në ligjet respektive të konkurrencës dhe komunikimeve elektronike dhe postare, Kodit të Procedurave Administrative dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi në momentin e nënshkrimit të këtij Memorandumi.
- 1.3. Procesi i shkëmbimit të informacionit do të bazohet në parimin e besueshmërisë reciproke, transparencës mes palëve për atë që lejon legjislacioni në fuqi, efikasitetin në përshpejtimin e kohës së shkëmbimit të informacionit dhe vullneti pozitiv për të vënë në dispozicion të palës tjetër gjithë informacionin e disponueshëm konform legjislacionit.
- 1.4. Shkëmbimi i informacionit në bazë të këtij Memorandumi do të jetë në përputhje me kufizimet që rrjedhin nga dispozitat e ligjit të brendshëm të Palëve.
- 1.5. Secila nga Palët duhet të garantojë konfidencialitetin për informacionin e marrë nga Pala tjetër. Informacioni i marrë në kuadër të këtij Memorandumi nuk mund të transferohet një pale të tretë pa pasur një autorizim me shkrim nga Pala e cila ka siguruar informacionin.

Neni 2 Përgjegjësitë e AKEP

- 2.1 AKEP-i në funksion të përmbushjes së detyrimeve të tij ligjore, në zbatim të ligjit nr. 99188/2008 “Për komunikimet elektronike dhe postare”, do të nxisë konkurrencën efiçente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, facilitetet shoqëruese dhe shërbimet e tjera;
- 2.2 Në procesin e përcaktimit të tregjeve dhe analizës së tyre, AKEP-i bashkëpunon me Autoritetin e Konkurrencës, duke kërkuar dhe marrë parasysh rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës lidhur me përcaktimin e tregjeve përkatëse, dokumentet e analizës së tregjeve, vendimmarrjen e Komisionit të Konkurrencës për shpalljen e një operatori ose jo me pozitën dominuese sipas legjislacionit të konkurrencës.

- 2.3 Operatorët me fuqi të ndjeshme në treg (OFNT), që ofrojnë rrjete dhe shërbime të komunikimeve elektronike publike, nuk duhet të abuzojnë me pozitën e tyre në treg.
- 2.4 Kur AKEP-i, me nismën e vet, ose nëpërmjet njoftimit nga sipërmarrës të tjerë apo palë të tjera të interesuara, gjykon se operatori me fuqi të ndjeshme në treg po abuzon me pozitën e tij, e parashtron rastin përpara Autoritetit të Konkurrencës, duke i kërkuar fillimin e procedurave përkatëse ligjore.
- 2.5 AKEP kërkon paraprakisht vlerësimin e Autoritetit për çdo projekt akt normativ që, në mënyrë të veçantë, ka të bëjë me:
- kufizimet sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin;
 - vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të drejtave të veçanta, në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara;
 - imponimin e praktikave të njëjta në çmime dhe kushtet e shitjes.

Neni 3 Përgjegjësitë e Autoritetit të Konkurrencës

- 3.1 Autoriteti i Konkurrencës, është institucioni përgjegjës i cili siguron një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, edhe në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare në zbatim të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”
- 3.2 Autoriteti, për arsye të interesit të përgjithshëm, vlerëson, në veçanti, barrierat rregulluese të konkurrencës, të përfshira në rregullimin ekonomik dhe administrativ. Në këto raste Autoriteti bën rekomandimet përkatëse, të cilat i drejtohen çdo institucioni publik, dhe enti rregullator.
- 3.3 Autoriteti, për zbatimin të ligjit nr. 9121/2003 në sektorët e rregulluar, bashkëpunon me entet dhe institucionet e tjera rregullatore.
- 3.4 Autoriteti i Konkurrencës vlerëson shkallën e kufizimit ose të pengimit të konkurrencës që rrjedh nga projekt aktet sipas nenit 69 të ligjit nr. 9121/2003.
- 3.5 Autoriteti i Konkurrencës i kërkon opinion AKEP-it në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare lidhur me aktet nënligjore, rregullore dhe udhëzues që i referohen kryesisht përcaktimit të tregjeve përkatëse të produktit dhe atij gjeografik, shpalljes së një ose disa operatorëve me pozitë dominuese në tregjet përkatëse dhe analizës së konkurrencës në këto tregje.

Neni 4 Grupet e përbashkëta të ekspertëve

Palët mund të ndërtojnë grupe të përbashkëta pune të ekspertëve, sipas nevojës, *ad-hoc*, për aspektet e analizës së tregjeve, procedurave të inspektimit apo bashkëpunimit ndërinstucional për çështje të karakterit të përbashkët sipas parashikimeve të

legjislacionit përkatës në fuqi. Secila Palë i bart shpenzimet e veta lidhur me ekspertët e saj.

Neni 5

Organizimi i konferencave

Palët, kur është e përshtatshme, do të informojnë dhe do të ftojnë njëra-tjetrën në workshop-e, seminare, simpoziume dhe konferenca kombëtare dhe/ose ndërkombëtare të organizuara nga palët, Komisioni Evropian, OECD, ICN, BEREC apo autoritetet simotra të vendeve të rajonit, BE e më gjerë.

Neni 6

Koherenca e takimeve mes palëve

Titullarët e lartë të Palëve respektive do të takohen rregullisht dhe jo më pak se dy herë në vit për t'u konsultuar për sa i përket implementimit të këtij Memorandumi, në mënyrë që të vendosin prioritetet e bashkëpunimit brenda kësaj kornize për vazhdimin e të njëjtit akt, shkëmbimin e pikëpamjeve dhe, ato, sipas mundësisë, do të ndërmarrin veprime dhe pozicione të përbashkëta në forume dhe organizata evropiane dhe ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me sektorin e komunikimeve.

Neni 7

Analiza e zbatimit të Memorandumit

Palët do të shqyrtojnë në baza dyvjetore, rezultatet e bashkëpunimit të tyre sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit. Sipas nevojës, Palët do të ndërmarrin hapa për përmirësimin e bashkëpunimit dhe do të bëjnë propozime të përshtatshme për të ndryshuar fushën e veprimit të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit.

Neni 8

Pikat e kontaktit

Pikat e kontaktit për ndjekjen e zbatimit të Memorandumit janë si vijon:

Për AKEP: **Bleron Dokle**
+355 692083008
bleron.dokle@akep.al

Për Autoritetin e
Konkurrencës: **Denis Demiri**
+355 695435270
denis.demiri@caa.gov.al

Neni 9
Dispozitë kalimtare

Memorandumi i Mirëkuptimit i firmosur me datë 29.08.2007 mes Autoritetit të Konkurrencës dhe Entit Rregullator të Telekomunikacioneve shfuqizohet.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Ky Memorandum i Mirëkuptimit hyn në fuqi nga data e më poshtë shënuar dhe mund të ndërpritet nga secila Palë, duke njoftuar Palën tjetër paraprakisht në një afat kohor prej një (1) muaji.

U firmos dhe hyn në fuqi me datë 04/05/2018.

**Në emër të Autoritetit të
Komunikimeve Elektronike dhe
Postare (AKEP)**

Në emër të Autoritetit të Konkurrencës

Illir ZELA
Kryetar i Këshillit Drejtues



Juliana LATIFI
Kryetare

